



Projekti: UTF/ALB/010/ALB

"RIKUPERIMI I DËMEVE NË BUJQËSI DHE KTHIMI I KAPACITETEVE PRODHUESE"

Vlerësimi i ndikimit - Komponenti i granteve të kompensimit

Në shkurt të vitit 2015, për tri ditë radhazi, në Shqipëri ra 200 milimetra shi dhe dëmtoi mijëra hektarë tokë bujqësore, së bashku me sera dhe infrastruktura të tjera bujqësore. Dy vjet më vonë, gjërat po ndryshojnë për mirë për bujqësinë shqiptare.

Rajonet më të goditura ishin në jug dhe juglindje të vendit. Në rajonet e Vlorës, Fierit, Lushnjës, Beratit, Korçës dhe Gjirokastrës janë dëmtuar rreth 10,000 hektarë tokë bujqësore. Kulturat ushqimore, kulturat e foragjereve dhe serat për prodhimin e hershëm të perimeve dhe frutave janë dëmtuar ose shkatërruar. Nën-sektori i blegtorisë u dëmtua në një masë më të vogël, edhe pse mungesa e ushqimit në muajt që pasuan do të ndikonte negativisht në prodhimin e kafshëve.

Bashkimi Europian, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, hartoi një program rimëkëmbje që shkoi përtej restaurimit të thjeshtë të kushteve të para-përmbytjeve dhe synoi të rriste përgjigjen ndaj fatkeqësive natyrore të ardhshme, me implikime infrastrukturore, institucionale dhe sociale.


Sot, projekti "Rikuperimi i dëmeve në bujqësi dhe kthimi i kapaciteteve prodhuese" ka hyrë në fazën e vlerësimit të aftësisë së fermerëve dhe komuniteteve rurale për t'iu përgjigjur këtyre katastrofave natyrore.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me ndihmën e FAO-s ka zhvilluar një procedurë për monitorimin e impaktit për grantet e kompensimit. Qëllimi i vlerësimit ishte studimi dhe vlerësimi i ndikimit dhe gjendjes së zhvillimit, statusit dhe nevojave të popullsisë së prekur nga përmbytjet në rajonet e Korçës, Fierit, Beratit, Gjirokastrës dhe Vlorës. Ky vlerësim merr në konsideratë statusin e familjeve të anketuara dhe përpiket të përcaktojë rimëkëmbjen e përgjithshme të familjeve pas fatkeqësisë. Në veçanti: 1) analizojnë jetesën e tyre, 2) vlerësojnë rikuperimin e arritur dhe çdo ndryshim në stilin e jetesës, 3) vlerësojnë përshtatshmërinë e granteve të kompensimit si instrument rimëkëmbje, 4) vlerësojnë aftësitë e familjeve për t'u përballur me goditjet e ngjashme në të ardhmen, 5) perceptimi mbi mundësitë për zvogëlimin e ekspozimit ndaj goditjeve. Studimi mat situatën ekonomike dhe sociale të 16 386 banorëve (3 525 familjeve), duke vëzhguar jetesën e tyre dhe duke vlerësuar zhvillimin pas ekspozimit ndaj goditjeve. Modeli i vlerësimit përbëhej nga 445 intervista.

Vlerësimi i Ndikimit ka konfirmuar se shumica dërrmuese e familjeve të prekura kanë investuar fondet e kompensimit në rehabilitimin e prodhimit të tyre bujqësor, duke arritur në pjesën më të madhe, rimëkëmbjen e qëndrueshme dhe rifillimin e aktiviteteve.

Projekti: UTF/ALB/010/ALB

"RIKUPERIMI I DËMEVE NË BUJQËSI DHE KTHIMI I KAPACITETEVE PRODHUESE"



Gjetjet kryesore të vlerësimit janë renditur më poshtë:

Treguesit demografikë

Madhësia mesatare e familjeve të prekura nga përmbytjet është më pak se pesë persona, ku mbizotërojnë meshkujt, në krahasim me femrat, përafërsisht 6.3 për qind. Një total prej 40 përqind e familjeve janë në pension dhe 46 përqind e familjeve kanë persona të mitur, ku numri i djemve është më i lartë se numri i vajzave, në përputhje me trendin e popullsisë së përgjithshme. Popullsia e mitur është nën mesataren kombëtare për zonat rurale prej 25 përqind. Pjesa e popullsisë në moshë pune është mesatarisht në 68.3 përqind.

Treguesit ekonomikë

Nuk ka familje me burime të ardhurash të pa identifikuar. Mesatarisht pak më shumë se gjysma e popullsisë kontribuon në të ardhurat e familjes. Pjesa e popullsisë që gjeneron të ardhura varion nga një e katërta e gjysmës së popullsisë së përgjithshme.

Bujqësia është burimi më i rëndësishëm i të ardhurave për shumicën e familjeve, megjithatë më pak se një e dhjeta e të gjithë fermerëve janë të përfshirë në shkallë tregtare/prodhimi bujqësor profesional. Si të tillë, të anketuarit në parim nuk e konsiderojnë përfshirjen në bujqësi si punësim.

Të ardhurat bujqësore ndiqen qartazi nga të ardhurat nga pensionet në afërsisht një të dhjetën e popullsisë.

Pagat nga puna e rregullt kontribuojnë në më pak se një të dhjetën e punësimit të përgjithshëm dhe tejkalohe nga dërgesat dhe transfertat sociale.

Vetëpunësimi është burim i të ardhurave për një pjesë shumë të kufizuar të popullsisë.



Projekti: UTF/ALB/010/ALB

"RIKUPERIMI I DËMEVE NË BUJQËSI DHE KTHIMI I KAPACITETEVE PRODHUESE"

Papunësia është një pengesë e rëndësishme, që prek pothuajse 40 përqind të të gjitha familjeve. Papunësia si pjesë e popullatës rri pezull në një të katërtën e popullsisë së përgjithshme ose në më shumë se një të tretën e popullsisë së përgjithshme të moshës së punës. Më pak se një e pesta e numrit të të papunëve janë femra.

Pavarësisht nga papunësia e lartë, më pak se një e treta e të papunëve janë në fakt në kërkim të punësimit.

Zhvillimet në gjendjen ekonomike gjatë 12 muajve të fundit tregojnë se për më shumë se gjysmën e familjeve gjendja socio-ekonomike ka mbetur në vend. Ndërsa për një të pestën e familjeve, kjo gjëndje është përmirësuar.

Prodhimi bujqësor

Rezultatet konfirmojnë se pothuajse të gjitha familjet e intervistuar kanë në pronësi dhe kultivojnë tokë bujqësore. Përfituesit e projektit mesatarisht raportuan 0.35 hektarë tokë të përmbytur, ose 21.8 përqind krahasuar me mesataren e tokës në pronësi.

Fragmentimi i madh i tokës është i dukshëm me mesatarisht katër parcela për familje dhe me madhësi mesatare të tokës që varion midis 0.25 dhe 0.7 ha. Parcelat e tokës në shumicën dërrmuese të rasteve janë në bashkëpronësi të burrave dhe grave.

Shumica e familjeve dhe më shumë se gjysma e popullsisë së synuar janë të angazhuar në prodhimin bimor, ku meshkujt e familjes janë më të përfshirë në krahasim me femrat.

Pjesa më e madhe e tokës është mbjellë me kultura të kombinueshme, të cilat kërkojnë investime të kufizuara dhe krahë pune. Pak më shumë se një e treta e familjeve po prodhojnë kultura shumëvjeçare (pemishte dhe vreshta) dhe pak më shumë se një e katërta e familjeve prodhojnë perime.

Shumica dërrmuese e të anketuarve janë fermerët ekzistues që kryesisht prodhojnë kultura për konsum të tyre dhe për shitje të rastit. Më shumë se gjysma e tyre zotërojnë bagëti (kryesisht pula dhe/ose gjedh), dhe një e katërta zotëron ripërtypës të vegjël.

Pagesat e kompensimit

Një e katërta e përfituesve konfirmuan se dëmet dhe humbjet e tyre janë kompensuar plotësisht. Të anketuarit e mbetur e cituan kompensimin si të pjesshëm, mesatarisht 40 përqind të dëmeve dhe humbjeve të tyre. Më pak se një përqind e të anketuarve e konsideruan shumën e kompensimit si të papërfillshme.

Kombinuar me të anketuarit që konfirmuan kompensimin e plotë të dëmeve dhe humbjeve të tyre, përfituesit e projektit e kanë vlerësuar kontributin e kompensimit më shumë se gjysma e humbjeve të tyre të përgjithshme.



Projekti: UTF/ALB/010/ALB

"RIKUPERIMI I DËMEVE NË BUJQËSI DHE KTHIMI I KAPACITETEVE PRODHUESE"

Një e treta e të anketuarve, arritën të rikuperohen në nivelet e para-katastrofës dhe gjysma e të anketuarve arritën rikuperim të pjesshëm. Pjesa e të anketuarve, të cilët konsiderojnë se rimëkëmbja e tyre është e ulët ose fare, vlerësohet 13 përqind.

Shumica e të anketuarve janë mesatarisht të kënaqur me kompensimin, çereku i tyre janë shumë të kënaqur në përgjithësi. 15 përqind e të anketuarve nuk janë aspak të kënaqur me mbështetjen e marrë.

Të anketuarit kanë shpenzuar plotësisht shumën e transferuar brenda tre muajve nga marrja e tyre, kryesisht në investimet bujqësore. Shumica e të anketuarve investuan pothuajse shumën e plotë në prodhimin bujqësor ose investimet "të tjera". Nga ana tjetër, shumica mesatare e shpenzuar për përmirësimet në shtëpi përbënte gjysmën e vlerës së kompensimit të marrë.

Përshtatshmëria ndaj fatkeqsive

Shumica e të anketuarve janë të mendimit se vetëm investimet në infrastrukturën publike (drenazhimi, mbrojtja nga përmbytjet) mund të zvogëlojnë realisht nivelin e rrezikut nga përmbytjet. Ndërsa një pjesë e rëndësishme janë skeptikë nëse mund të gjendet zgjidhja për ekspozimin e tyre ndaj rreziqeve nga përmbytjet.

Shumica e të anketuarve gjykojnë se mbështetja e investimeve për prodhimin e tyre bujqësor mund t'i ndihmojë ata të zhvillojnë prodhimin e tyre. Ndihma e dytë më e preferuar është trajnimi dhe transferimi i njohurive, të cilat do të plotësonin mbështetjen e investimeve të ofruara.

Përfundime

- Shuma e kompensimit në përgjithësi u vlerësua si e drejtë, si nga fermerët ashtu edhe nga aktorët e nivelit lokal.
- Programi ka arritur objektivin e rikthimit të jetesës së familjeve të prekura dhe rimëkëmbjen e prodhimit bujqësor, pasi shumica e popullsisë ka rikuperuar aktivitetet e tyre duke përdorur tokën e tyre bujqësore.
- Koha e ndërhyrjes për rimëkëmbje ishte e përshtatshme në aspektin e kalendarit bujqësor, megjithatë e vonuar për adresimin e nevojave më urgjente të popullsisë pas përmbytjeve.
- Mekanizmi parësor i transferimit të parave ka qenë praktik për shpërndarjen efikase të parave në formë grantesh dhe lejoi që disbursimi të zbatohet në kohë dhe në mënyrë kohezive.



Projekti: UTF/ALB/010/ALB

"RIKUPERIMI I DËMEVE NË BUJQËSI DHE KTHIMI I KAPACITETEVE PRODHUESE"

- Pabarazia gjinore është e kufizuar në shumicën e komuniteteve, me nivele relativisht të kënaqshme të pjesëmarrjes së femrave në proces dhe vendimmarrje. Megjithatë, kemi ende hapsira për përmirësim.
- Hallka të shumëfishta të menaxhimit kanë ndikuar në një farë mase në realizimin në kohë të programit. Megjithatë duke pasur parasysh se kjo ishte një përpjekje e parë e shoqëruar me parakushtet për zhvillimin e kapaciteteve, rezultati dhe përvoja e përgjithshme mund të konsiderohen si pozitive.
- Shumica e të anketuarve përballen me sfida në zhvillimin e prodhimit bujqësor. Shumë prodhues mbështeten në praktika ekstensive e jo intesive, të cilat në fund të fundit e dëmtojnë produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e tyre. Ndërsa theksi i programit ishte rivendosja e aktiviteteve bujqësore, ajo dha rezultate të kufizuara drejt zhvillimit dhe përmirësimit të qëndrueshmërisë.